

**ALBA LIGHT SH.P.K**

**Raporti i Audituesit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare më dhe  
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Aksionarëve të Shoqërisë ALBA LIGHT sh.p.k.

### Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë ALBA LIGHT sh.p.k. (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

#### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### Theksimi i Çështjes

Siç është paraqitur në shënimin "Hua Afatgjata" të pasqyrave financiare kompania ka raportuar huamarrje në vlerën prej 24 milion LEK (2016: 22 milion LEK), huamarrje e cila nuk mbeshtetet nga kontrata noteriale të lidhura mes palëve. Në mungesë të një kontrate ku përcaktohen termat e shlyrjes dhe interesi i aplikueshëm kompania nuk ka bërë rregullime për vlerën e drejtë të kësaj huamarrjeje dhe në vlerën e interesit të pagueshëm, më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2017. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne, gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.



- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Në komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Për Net-SFS Kreston Sh.p.k.

**Rezar LLUKAÇEJ**  
Partner Angazhimi

*Tiranë më, 4 maj 2018*



PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI AUDITIMIT	3-5
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	6-7
PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE	8
PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT AKSIONAR	9
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	10
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	11-20

## ALBA LIGHT SH.P.K

## Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	2017	2016
<b>Aktivet</b>				
<b>Aktivet afatshkurtra</b>				
<b>Mjetet monetare</b>				
		<b>1</b>	<b>5,735,562</b>	<b>2,521,300</b>
1	Banka		5,569,720	2,410,794
7	Arka		165,842	110,506
<b>Investime</b>				
		<b>2</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
1	Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit	2.1	-	-
2	Aksionet e veta	2.2	-	-
3	Të tjera Financiare	2.3	-	-
<b>Të drejta të arkëtueshme</b>				
		<b>3</b>	<b>13,794,900</b>	<b>8,766,050</b>
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	3.1	11,681,413	6,794,379
2	Nga njësitë ekonomike brenda grupit	3.2	-	-
3	Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	3.3	-	-
4	Të arkëtueshme të tjera	3.4	2,113,487	1,971,671
5	Kapitali nënshkruar i papaguar	3.5	-	-
<b>Inventarët</b>				
		<b>4</b>	<b>53,323,844</b>	<b>41,875,875</b>
1	Lende e parë dhe materiale të konsumueshme	4.1	-	-
2	Prodhime në proces dhe gjysëmprodakte	4.2	-	-
3	Produkte të gatshme	4.3	-	-
4	Mulha	4.4	53,323,844	41,875,875
5	Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	4.5	-	-
6	AAGJM të mbajtura për shitje	4.6	-	-
7	Parapagime për inventar	4.7	-	-
<b>Shpenzime të shtyra</b>				
		<b>5</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>				
		<b>6</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>I</b>	<b>TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA</b>		<b>72,854,306</b>	<b>53,163,225</b>
<b>Aktivet Afatgjata</b>				
<b>Aktive financiare</b>				
		<b>7</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
1	Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	7.1	-	-
2	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	7.2	-	-
3	Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.3	-	-
4	Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.4	-	-
5	Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata	7.5	-	-
6	Tituj të tjerë të huadhënies	7.6	-	-
<b>Aktivet materiale</b>				
		<b>8</b>	<b>9,746,280</b>	<b>7,613,863</b>
1	Toka dhe ndërtesa	8.1	-	-
2	Impionte dhe makineri	8.2	7,511,566	4,976,979
3	Të tjera instalime dhe pajisje	8.3	2,234,714	2,636,884
4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	8.4	-	-
<b>Aktive biologjike</b>				
		<b>9</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Aktive jo materiale:</b>				
		<b>10</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
1	Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme	10.1	-	-
2	Fundi i Mirë	10.2	-	-
3	Parapagime për AAJM	10.3	-	-
<b>Aktive tatimore të shtyra</b>				
		<b>11</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Kapitali i nënshkruar i papaguar</b>				
		<b>12</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>II</b>	<b>TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA</b>		<b>9,746,280</b>	<b>7,613,863</b>
<b>AKTIVE TOTALE</b>			<b>82,600,586</b>	<b>60,777,088</b>

Shënime shoqëruese nga 11 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## ALBA LIGHT SH.P.K

## Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	2017	2016
<b>Detyrime afatshkurtra:</b>		<b>13</b>	<b>45,868,430</b>	<b>25,437,184</b>
1	Titujt e huamarrjes	13.1	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	13.2	24,260,523	18,095,113
3	Arkëtime në avancë për porosi	13.3	1,562,320	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13.4	19,245,570	4,984,761
5	Dëftesa të pagueshme	13.5	-	-
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	13.6	-	-
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	13.7	-	-
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	13.8	749,804	509,949
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	13.9	50,213	1,847,361
10	Të tjera të pagueshme	13.10	-	-
	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	14	-	-
	Të ardhura të shtyra	15	-	-
	Provizione	16	-	-
<b>Totali i Detyrimeve afatshkurtera</b>			<b>45,868,430</b>	<b>25,437,184</b>
<b>Detyrime afatgjata:</b>		<b>17</b>	<b>24,002,051</b>	<b>21,543,064</b>
1	Titujt e huamarrjes	17.1	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	17.2	24,002,051	21,543,064
3	Arkëtime në avancë për porosi	17.3	-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	17.4	-	-
5	Dëftesa të pagueshme	17.5	-	-
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit	17.6	-	-
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	17.7	-	-
8	Të tjera të pagueshme	17.8	-	-
	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	18	-	-
	Të ardhura të shtyra	19	-	-
	Provizione:	20	-	-
1	Provizione për pensionet	20.1	-	-
2	Provizione të tjera	20.2	-	-
<b>Detyrime tatimore të shtyra</b>		<b>21</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>			<b>24,002,051</b>	<b>21,543,064</b>
<b>DETYRIMET TOTALE</b>			<b>69,870,481</b>	<b>46,980,248</b>
	Kapitali dhe Rezervat	22	-	-
	Kapitali i Nënshkruar	23	10,000,000	100
	Primi i lidhur me kapitalin	24	-	-
	Rezerva rivlerësimi	25	-	-
	Rezerva të tjera	26	502,722	-
1	Rezerva ligjore	26.1	502,722	-
2	Rezerva statutare	26.2	-	-
3	Rezerva të tjera	26.3	-	-
	Fitimi i pashpërndarë	27	-	2,169,944
	Fitim / Humbja e Vitit	28	2,227,383	11,626,796
<b>Totali i Kapitalit</b>			<b>12,730,105</b>	<b>13,796,840</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>			<b>82,600,586</b>	<b>60,777,088</b>

Shënimet shoqëruese nga 11 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## ALBA LIGHT SH.P.K

## Pasqyra e performances financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	2017	2016
	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	110,219,248	103,078,162
	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	30	-	-
	Punë e kryer nga njësi ekonomike dhe e kapitalizuar	31	-	-
	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32	312,161	181,883
	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33	(85,993,899)	(72,640,108)
	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33.1	(85,993,899)	(72,640,108)
	Të tjera shpenzime	33.2	-	(9,676,812)
	Shpenzime të personelit	34	(7,546,648)	(5,553,991)
	Paga dhe shpërblyme	34.1	(6,466,707)	(4,759,000)
	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	34.2	(1,079,941)	(794,991)
	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	35	-	-
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	(1,804,296)	(1,022,277)
	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	(11,239,710)	(182,213)
	Të ardhura të tjera	38	-	-
	Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)	38.1	-	-
	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)	38.2	-	-
	Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)	38.3	-	-
	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	39	-	-
	Shpenzime financiare	40	(1,150,267)	(420,435)
	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	40.1	(1,150,267)	(420,435)
	Shpenzime të tjera financiare	40.2	-	-
	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	41	-	-
	Fitimi/Humbja para tatimit	42	2,796,589	13,764,209
	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	43	(569,206)	(2,137,413)
	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	43.1	(569,206)	(2,137,413)
	Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë	43.2	-	-
	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve	43.3	-	-
	Fitimi/Humbja e vitit	44	2,227,383	11,626,796
	Fitimi/Humbja për:	45	-	-
	Pranarët e njësisë ekonomike nënë	45.1	-	-
	Interesat jo-kontrolluese	45.2	-	-
	Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse		-	-
Nr	Pershkrimi i Elementeve		2017	2016
	Fitimi/Humbja e vitit	46	2,227,383	11,626,796
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	46.1	-	-
	Diferencat (+/-) nga përkllimi i monedhës në veprimtari të huaja	46.2	-	-
	Diferencat (+/-) nga rievlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	46.3	-	-
	Diferencat (+/-) nga rievlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shita	46.4	-	-
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	46.5	-	-
	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	47	-	-
	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	48	2,227,383	11,626,796
	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:	49	-	-
	Pranarët e njësisë ekonomike nënë	49.1	-	-
	Interesat jo-kontrolluese	49.2	-	-

Shënimet shoqëruese nga 11 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**ALBA LIGHT SH.P.K**

**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2017**

(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

	Kapitali i Nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva rivlerësimi	Rezerva ligjore	Rezerva statutore	Rezerva të tjera	Fitim i pashpërndarë	Fitim / Humbla e Vetit	Totali
<b>pozicioni financiar i ndëkruar më 1 janar 2017</b>	100	-	-	-	-	-	2,169,944	11,626,796	13,796,840
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:									
- Fitimi / Humbla e vitit								2,227,383	2,227,383
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:									
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:				502,722			113,796,740		(9,294,118)
Emëtimi i kapitalit të nënshkruar	9,999,900								
Dividendë të paguar									
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				502,722			(11,626,796)	13,854,179	
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>10,000,000</b>			<b>502,722</b>			<b>(11,626,796)</b>	<b>13,854,179</b>	<b>12,730,105</b>

Shënimet shoqëruese nga 11 deri në 20 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

**ALBA LIGHT SH.P.K**

**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)*

Metoda Indirekte		2017	2016
<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi i Elementeve</b>		
	<i>Fitim / Humbja e vitit</i>	2,227,383	11,626,796
	<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
	<i>Shpenzimet financiare jomonetare</i>		-181,883
	<i>Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar</i>		
	<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	1,804,296	1,022,277
	<i>Zhvlerësimi i aktiveve ofatgjata materiale</i>		
	<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
	<i>Fitim nga shitja e aktiveve ofatgjata materiale</i>		
	<i>Ndryshimet në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
	<i>Rritje/(ritje) në të drejtat e arketueshme dhe të tjera</i>	(5,028,850)	(3,118,145)
	<i>Rënie/(ritje) në inventarë</i>	(11,447,909)	(8,685,283)
	<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	20,191,391	(17,938,996)
	<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>	239,855	
	<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>7,986,106</b>	<b>(17,275,734)</b>
	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
	<i>Para neto të përdorura për blerjen e filialeve</i>		
	<i>Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve</i>		
	<i>Pagesa për blerjen e aktiveve ofatgjata materiale</i>	(3,936,713)	(4,956,481)
	<i>Arketime nga shitja e aktiveve ofatgjata materiale</i>		
	<i>Pagesa për blerjen e investimeve të tjera</i>		
	<i>Arketime nga shitja e investimeve të tjera</i>		
	<i>Dividentë të arkëtuara</i>		
	<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>(3,936,713)</b>	<b>(4,956,481)</b>
	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
	<i>Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar</i>		
	<i>Arketime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
	<i>Hua të arkëtuara</i>	2,458,987	21,078,655
	<i>Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë</i>		
	<i>Riblerje e aksioneve të veto</i>		
	<i>Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral</i>		
	<i>Pagesa e huave</i>		
	<i>Pagesë e detyrimeve të qasës financiare</i>		
	<i>Interes i paguar</i>		
	<i>Dividendë të paguar</i>	(1,294,118)	
	<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>(835,131)</b>	<b>21,078,655</b>
	<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>3,214,262</b>	<b>(1,153,060)</b>
	<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 Janar 2017</b>	<b>7,571,300</b>	<b>3,492,477</b>
	<i>Efekti i llogatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		181,883
	<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017</b>	<b>5,735,562</b>	<b>2,521,300</b>

*Shënimet shoqëruese nga 11 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**Administratoret**

**Altin Nerva**

**Artan Kodragjini**

**Alba Light SH.P.K**

**Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

*(të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)*

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Shoqëria Alba Light Sh.p.k, themeluar si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 07/01/2014, me NUIS L413070381, ushtron aktivitetin e saj në fushën e " Import-Eksport dhe shitblerje e materialeve elektrike, instalime dhe shërbime në fushën e materialeve elektrike të sigurisë etj.", me adresë Kashar, Yzberisht, Rruga Teodor Keko, godina Pelivani, kati 1, Tiranë.

Kapitali i shoqërisë, sipas vendimit të shoqërisë dhe raportit të ekspertit kontabel datë 01.08.2017, për zmadhimin e kapitalit bëhet në vlerën 10.000.000 lëke dhe përbëhet nga kontributi i Ortakeve:

- Z. Altin Nervaj 50 % të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Artan Kodragjini 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria Alba Light Sh.p.k. ka si përfaqësuesë ligjor Z. Altin Nervaj dhe Z. Artan Kodragjini.

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

Pasqyrat financiare shoqëruese janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", duke aplikuar standardet kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratuara nga Ministri i Financave.

Monedha funksionale dhe prezantuese e Shoqërisë është LEK.

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Keto pasqyra financiare janë përgatitur dhe prezantuar në Lek Shqiptar "LEK".

### **2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrorjnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabel dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.



## 2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

### 2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

## 3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhë të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të dates së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të dates kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me EURO me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
EURO (EUR)	132.95	135.23
USD (USD)	111.10	128.17

### 3.2 Instrumentat financiare

Instrumentat financiare jo-derivativë përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiare jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 4.



### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Vlera e drejtë*

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, e kërkesave për t'u arketuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### 3.3 Inventarët

Inventarët (mallrat) janë pasqyruar me kosto historike.

### 3.4 Aktive afatgjata materiale

#### *l. Njohja dhe matja*

Aktivët afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndarë (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### *i. Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të aktive afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

**3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)****3.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Metodat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajseje dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.

Kategoria e aktivitet	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Pajise zyre dhe informatike	Mbi vlerën e mbetur	25%
Makineri e Pajisje	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën e mbetur	20%

**3.5 Aktive afatgjata jomateriale**

Aktivitet jo materiale, të cilat përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike, njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka. Amortizimi shpërndahet duke përdorur metodën e amortizimit linear. Norma e amortizimit e përdorur për aktivitet afatgjata jo materiale është 20%. Jeta e dobishme e vlerësuar dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese vjetore, duke njohur në periudhat pasuese efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël.

**3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur produktet dhe shërbimet janë përfunduar, kryer, në përputhje me SKK 8 Të ardhurat.

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- Shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat gjenerohen nga shërbimet e ofruara klientëve bazuar në kontratë dhe njihen sipas çmimeve për njësi për çdo kontratë të realizuar.

Të ardhurat nga shitja e të mirave do të njihen vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Kompania ka transferuar tek blerësi riskun dhe të drejtën e pronësisë lidhur me mallin e shitur.
- Kompania nuk ushtron përfshirje të vazhdueshme manaxheriale, zakonisht të lidhur me pronësinë apo kontrollin mbi mallrat e shitura.
- Shuma e të ardhurës së përfituar mund të matet në mënyrë të besueshme.
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me kryerjen e veprimtimit të shitjes së mallrave të hyjnë në një njësinë ekonomike.

Kostot e lidhura me shitjen e mallit mund të maten në mënyrë të besueshme.

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.7 Shpenzime për personelin

##### *Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*

Gjatë aktivitetit të saj normal, Shoqëria kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet e sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ndodhin.

#### 3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, humbjet nga kurset e këmbimit, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare (nëse ka).

#### 3.9 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës. Përqindja e tatim fitimit në fuqi gjatë vitit 2017 ishte 15% (2014: 10%).

#### 3.10 Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

Alba Light SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

#### 4. Aktivet

##### 4.1 Aktivet Afatshkurtra

###### a. Arka dhe Banka

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Arka Lek	156,247	101,803
Arka eur	9,154	8,262
Arka usd	441	441
Banka lek	3,198,063	859,940
Banka eur	2,340,010	1,458,785
Banka Usd	31,648	92,069
<b>TOTALI</b>	<b>5,735,562</b>	<b>2,521,300</b>

###### b. Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Klente për mallra dhe shërbime	11,681,413	6,794,379
<b>TOTALI</b>	<b>11,681,413</b>	<b>6,794,379</b>

###### c. Të arkëtueshme të tjera

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Tatim mbi fitimin	1,135,019	-
Shteti - TVSH për të marrë	915,968	1,971,671
Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer	62,500	-
<b>TOTALI</b>	<b>2,113,487</b>	<b>1,971,671</b>

###### d. Inventarët

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Mallra	53,323,844	41,875,875
<b>TOTALI</b>	<b>53,323,844</b>	<b>41,875,875</b>



## Alba Light SH.P.K

## Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

## 4.2 Aktivet Afatgjata

## 4.2.1 Aktivet afatgjata materiale

	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informative	Te tjera	Totali
<i>Kosto</i>					
Më 1 janar 2016	3,484,250	736,985	157,980		4,379,215
Shtesa	2,823,501	1,836,530	334,955	38,775	5,033,761
Pakësime					-
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>6,307,751</b>	<b>2,573,524</b>	<b>492,935</b>	<b>38,775</b>	<b>9,412,985</b>
Shtesa	3,832,880		103,813		3,936,713
Pakësime					-
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>10,140,631</b>	<b>2,573,524</b>	<b>596,768</b>	<b>38,775</b>	<b>13,349,698</b>
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>					
Më 1 janar 2016	598,975	131,750	27,341		758,016
Zhvlerësimi vjetor	781,847	171,855	69,114	18,290	1,041,106
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,380,772</b>	<b>303,605</b>	<b>96,455</b>	<b>18,290</b>	<b>1,799,122</b>
Zhvlerësimi vjetor	1,748,293	453,849	93,132	9,022	1,804,296
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,629,065</b>	<b>757,454</b>	<b>189,587</b>	<b>27,312</b>	<b>3,603,418</b>
<i>Vlera e mbetur neto</i>					
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>7,511,566</b>	<b>1,816,070</b>	<b>407,181</b>	<b>11,463</b>	<b>9,746,280</b>
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>5,708,826</b>	<b>2,441,774</b>	<b>465,594</b>	<b>38,775</b>	<b>7,613,863</b>

## 5. Detyrimet

## 5.1 Detyrimet afatshkurtra

## 5.1.1 Huamarrje Afatshkurtra

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj institucioneve te kredite	5,962,278	18,095,113
Hua te tjera	18,298,246	-
<b>TOTALI</b>	<b>24,260,523</b>	<b>18,095,113</b>

## 5.1.2 Arketime ne avance per porosi

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Arketime në avancë për porosi LEK	1,562,320	-
<b>TOTALI</b>	<b>1,562,320</b>	<b>-</b>

## 5.1.3 Të pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Furnitore per mallra dhe shërbime	19,245,570	4,984,761
<b>TOTALI</b>	<b>19,245,570</b>	<b>4,984,761</b>

Alba Light SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

#### 5.1.4 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Paga dhe shpërblime	566,783	385,236
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	183,021	124,713
<b>TOTALI</b>	<b>749,804</b>	<b>509,949</b>

#### 5.1.5 Të pagueshme për detyrimet tatimore

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Tatim mbi të ardhurat personale	15,730	11,700
Taksa të tjera	34,483	38,694
Tatim mbi fitimin	-	1,795,967
<b>TOTALI</b>	<b>50,213</b>	<b>1,847,361</b>

### 5.2 Detyrimet afatgjata

#### 5.2.1 Huamarrje afatgjata

	me 31 dhjetor 2017	me 31 dhjetor 2016
Detyrime ndaj institucionave të kredise	24,002,051	21,543,064
<b>TOTALI</b>	<b>24,002,051</b>	<b>21,543,064</b>

### 6. Kapitali i pronarit

Kapitali i shoqërisë ka vlerën prej 10,000,000 LEK dhe përbëhet nga kontributi i Ortakeve:

- Z. Altin Nervaj 50 % të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Artan Kodragjini 50 % të kapitalit të shoqërisë.

### 7. Të ardhurat dhe shpenzimet

#### 7.1. Të ardhurat

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shitje e mallrave dhe e shërbimeve	110,531,409	103,760,045
<b>TOTALI</b>	<b>110,531,409</b>	<b>103,760,045</b>

#### 7.2 Shpenzimet

##### 7.2.1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Blerja materiale të para	85,993,899	72,640,108
<b>TOTALI</b>	<b>85,993,899</b>	<b>82,316,920</b>

Alba Light SH.P.K

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

(të gjitha shumat janë në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

#### 7.2.2 Shpenzime personeli

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime per page	6,466,707	4,759,000
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,079,941	794,991
<b>TOTALI</b>	<b>7,546,648</b>	<b>5,553,991</b>

#### 7.2.3 Shpenzime konsumi dhe amortizimi

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime amortizimi	1,804,295	1,022,277
<b>TOTALI</b>	<b>1,804,295</b>	<b>1,022,277</b>

#### 7.2.4 Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Kancelari&shpenzime zyre	339,221	274,997
Qira	7,460,517	1,323,800
Mirëmbajtje dhe riparime	759,460	655,621
Shpenzime per karburant	3,595,763	1,908,671
Shpenzime te tjera per aktivitetin	854,197	3,319,818
Shpenzime Sigurimi	414,170	348,377
Shpenzime transporti	453,365	-
Dieta	787,358	1,213,431
Shpenzime telefoni dhe internet	71,633	-
Publicitet , reklama	342,599	163,870
Shpenzime per komisione bankare	266,986	284,110
Taksa dhe Dogana	238,857	183,173
Gjoha dhe damshpërblime	655,557	182,213
<b>TOTALI</b>	<b>11,239,710</b>	<b>9,859,026</b>

#### 8. Të ardhura dhe shpenzime financiare

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Shpenzime të tjera financiare	1,150,267	420,435
<b>TOTALI</b>	<b>1,150,267</b>	<b>420,435</b>

#### 9. Fitim (humbja) e vitit

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016
Fitimi i vitit para tatimit	7,796,589	-
Shtese: Shpenzime te pabarritshme	998,116	485,211
Fitimi fiskal i vitit	3,794,705	485,211
Fitimi neto i tatueshem	3,794,705	485,211
Tatim fitimi me 15% (2014: 15%)	569,208	72,782
Tatim fitimi i parapaguar	1,704,225	(1,724,185)
Tatim fitimi per t'u paguar/(arketuar)	(1,135,019)	1,796,967

#### 10. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve ose detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pa konsideruar nëse mbahen ndalesa. Një palë e lidhur është një palë e cila kontrollon, është e kontrolluar nga ose është nën të njëjtin kontroll me, njësinë; ka një interes në njësi e cila jep ndikim domethenës mbi njësinë; ose ka kontroll mbi njësinë, është një ortak i njësisë; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi është pjesëmarrëse; ose është pjesë e personelit kryesor të drejtimit të njësisë ose të shoqërisë mëmë (përfshirë anëtarët e ngushtë të familjes të secilit prej individëve të referuar më sipër).

Shoqëria nuk ka transaksione me palët e lidhura.

#### 11. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje pas datës së mbylljes së bilancit që kërkon korrigjim apo shënime shtesë në pasqyrat financiare.

#### 12. ANGAZHIMET DHE PASIGURITË

Nuk ka angazhime dhe pasiguri që kërkojnë paraqitje ose korrigjim në pasqyrat financiare.

#### 13. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

##### a) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normave të interesit është rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumentave financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave lidhur me aktivet ndryshojnë nga maturitetet e interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Hapësira e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar për një instrument financiar tregon se në çfarë niveli Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut.

##### b) Rreziku i kredisë

Shoqëria nuk ka ndonjë ekspozim të madh ndaj rrezikut të kredisë, i cili mund të ndikojë në pozicionin financiar apo performancën e Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017.

##### c) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të ndjeshme ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare limitohen në llogari të pagueshme gjatë rrjedhës normale të aktivitetit.